



VENDIM

Nr. 63 Date 22 .09. 2009

PËR

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA
NGA ERE SHOQËRISË E-VENTO SRL ALBANIA SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit te Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë: E-Vento Srl Albania sh.p.k,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikes që i licensuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qënë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencen teknike të huaj,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 12 muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi afatet e përcaktuara në pikën 1, gërma “a”, dhe “d”, të Vendimit nr.84 datë 17.07.2008 “Për Licensimin e Shoqërisë E-Vento Srl Albania sh.p.k”.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM IN

Nr. 63 Date 22 .09. 2009

PËR

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA
NGA ERE SHOQËRISË E-VENTO SRL ALBANIA SH.P.K**

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|--------------------------|-------|--------|
| Bujar Nepravishta | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Ardian Haçi | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Shkëlqim Bozgo | _____ | _____ |